

Gjykata Supreme e Kosovës - kolegjii i përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Emine Kçiku dhe Nazmije Ibrahim, anëtare, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Sherif Krasniqi, lidhur me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje, të cilën e përfaqëson me autorizim Anita Shabani, paraqitur kundër vendimeve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, A.nr.178/2012 dhe A.nr.179/2001 datë 16.6.2012 dhe A.nr.181/2012, datë 18.6.2012, në lëndën e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Kaçanikut, në seancën e mbajtur më 22.6.2012, mori këtë

AKTGJYKIM

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje – Dega në Kaçanik, paraqitur kundër vendimeve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, A.nr.178/2012 datë 16.6. 2012, A.nr.179/2001 datë 16.6.2012.

II. Hidhet poshtë si e palejueshme ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje – Dega Kaçanik, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, A.nr.181/2012 datë 18.6.2012.

A r s y e t i m i

Lëvizja Vetëvendosje – Dega Kaçanik i ka paraqitur kësaj Gjykate më 19.6.2012, ankesë kundër vendimeve A.nr.178/2012 dhe A.nr.179/2001 datë 16.6.2012 dhe A.nr.181/2012, datë 18.6.2012 të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe parashtrës. Me vendimet e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, A.nr.178/2012 dhe A.nr.179/2001 datë 16.6.2012 është refuzuar si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje, kurse me vendimin A.nr.181/2012, datë 18.6.2012 është pranuar si e bazuar ankesa e PDK e datës 17.6.2012 dhe Lëvizjes Vetëvendosje i është shqiptuar dënimi me gjobë prej 2.000,00 €.

Lëvizja Vetëvendosje – Dega Kaçanik e konteston me ankesë ligjshmërinë e vendimeve të përmendura, për shkak të vërtetimit të gabuar e të mangët të gjendjes faktike dhe shkeljes së të drejtës materiale, duke propozuar që ankesa të pranohet dhe vendimi A.nr.181/2012 datë 18.6.2012 të anulohet, kurse vendimet A.nr.178/2012 datë 16.6. 2012, A.nr.179/2001 datë 16.6.2012 t'i kthehen Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës për rishqyrtim.

Paneli zgjedhor për ankesa dhe parashtrës, në përgjigje të padisë qëndroi në konstatimet e paraqitura në vendimet e kontestuara, duke propozuar që ankesa ndaj vendimit A.nr.181/2012, datë 18.6.2012 të hidhet poshtë si e palejueshme kurse ankesa ndaj vendimeve A.nr.178/2012 datë dhe A.nr.179/2001 datë 16.6.2012 të refuzohet si e pabazuar

Gjykata Supreme vlerësoi ligjshmërinë e vendimeve të kontestuara në drejtim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes ndaj ankesës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe konstatoi:

Ankesa e paditësit ndaj vendimeve të Panelit zgjedhor për ankesa dhe parashtresa A.nr.178/2012 dhe A.nr.179/2012 datë 16.6/2012 është e pabazuar, kurse ankesa ndaj vendimit A.nr.181/2012 datë 18.6.2012 është e palejueshme.

Gjykata konstatoi se me vendimet e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.178/2012 dhe A.nr.179/2012 datë 16.6/2012 janë refuzuar si të pabazuara ankesat e Lëvizjes Vetëvendosje, kurse me vendimin A.nr.181/2012 datë 18.6.2012 është pranuar si e bazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës, datë 17.6.2012 dhe Lëvizjes Vetëvendosje i është shqiptuar dënimi me gjobë prej 2.000 €.

Me nenin 56.1. të Ligjit të Procedurës Administrative parashikohet që barra e të provuarit të fakteve të paraqitura bie mbi palën e interesuar në procedurën administrative, pavarësisht nga obligimi i administratës për t'ua vënë në dispozicion palëve provat që ajo i ka në dispozicion.

Gjykata i vlerësoi si të pabazuara pretendimet e paditësit të paraqitura në ankesën kundër vendimeve A.nr.178/2012 dhe A.nr.179/2012 datë 16.6/2012, sepse janë në kundërshtim me gjendjen faktike që ka vërtetuar organi i paditur dhe me provat që ndodhen në shkresat e lëndës. Padiësi nuk i ka argumentuar me asnjë provë pretendimet e veta, kurse provat e paraqitura nuk janë me ndikim në marrjen e një vendimi tjetër në këtë çështje administrative.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, vendimet e kontestuara janë të qarta dhe të kuptueshme. Ato përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, e cila konstatoi se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt.

Për arsyet e mësipërme, Gjykata Supreme konstatoi se në këtë çështje administrative gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe plotësisht dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit, prandaj nuk i pranoi pretendimet e padisë, sepse nuk çojnë në konstatimin e një gjendje tjetër nga ajo që ka konstatuar organi i paditur.

Prandaj Gjykata Supreme konstatoi se është e pabazuar ankesa e paditësit që ka të bëjë me vendimet e Panelit zgjedhor për ankesa dhe parashtresa A.nr.178/2012 dhe A.nr.179/2012 datë 16.6/2012.

Në nenin 120.1 paragrafi (c) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës parashikohet që PZAP, nëse konstaton shkelje të këtij Ligji ose të Rregullave të KQZ, do t'i shqiptojë subjektit politik ose organizatës vëzhguese gjobën në shumën prej 50.000,00 €.

Në nenin 118.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, parashikohet mundësia e paraqitjes së ankesës kundër vendimit të PZAP. Ankesa që i paraqitet Gjykatës Supreme do të shqyrtohet atëherë kur dënimi i shqiptuar kalon shumën prej 5.000,00 €.

Duke qenë se me vendimin e PZAP, A.nr.181/2012, datë 18.6.2012, Lëvizjes Vetëvendosje i është shqiptuar dënimi me gjobë prej 2.000,00 €, kështu që, në vështrim të nenit 118.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sipas të cilit Gjykata Supreme do ta shqyrtojë ankesën, nëse dënimi i shqiptuar kalon shumë prej 5.000 €, e ankesa e paditësit u hodh poshtë si e palejueshme për sa i përket vendimit të PZAP A.nr181/2012 datë 18.6. 2012 .

Nga sa u parashtrua dhe në bazë të nenit 46 dhe nenit 34 par. 1.5 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 118.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
A.A.nr.72/2012, datë 22.6.2012

Procesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Nebojsha Boriçiq